



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), nenit 14, lidhur me nenin 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, e në mbështetje të nenit 19, paragrafi 3, pika 3.1, te Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019”, e konform neneve 15, 29, pika 2 të Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2020, miraton këtë:

V E N D I M

Neni 1

1.1 znj. Shemsije GASHI nga fshati Dubravë Komuna e Suharekës; Ljepet në shfrytëzim afatgjatë deri në 99, (nëntëdhjetë e nëntë) vite, **Banesa e cila gjendet në rrugën “**Brigada 123**” në Suharekë, **objekti “B”** hyrja “**H-4, Nr. 58**” sipas sistemit të unifikuar të adresave, **kati IX**, me sipërfaqe të përgjithshme prej **S=66.31m²**, numri i banesës **Nr. B9/5**, pasurisë shoqërore në emër të Komuna e Suharekës, për banim familjarë sipas rekomandimit 01-Nr-104-5191 datës 20.01.2020, të komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave.**

1.2 znj. Merita BAJRAKTARI nga Suhareka; Ljepet në shfrytëzim afatgjatë deri në 99, (nëntëdhjetë e nëntë) vite **Banesa, e cila gjendet në rrugën “**Brigada 123**” në Suharekë, **objekti “B”** hyrja “**H-4, Nr. 58**” sipas sistemit të unifikuar të adresave, **kati X**, me sipërfaqe të përgjithshme prej **S=66.31m²**, numri i banesës **Nr. B10/5**, pasurisë shoqërore në emër të Komuna e Suharekës, për banim familjarë, sipas rekomandimit 01-Nr-104-5191 datës 20.01.2020, të komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave.**

Neni 2

Afati për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme fillon të rrjedh nga data, **30.01.2020**, dhe përfundon afati më datën, **29.01.2119**, pas mbarimit të këtij afati ose ndërprerjes së parakohshme të kontratës e drejta e shfrytëzimit i kthehet Komunës së Suharekës si titullar faktik dhe juridik.

Neni 3

Obligohet Kryetari i Komunës që pas miratimit të vendimit nga Kuvendi i Komunës së Suharekës të nënshkruan kontratë me fituesin, me anë të së cilës i përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

Neni 4

4.1 Obligohen shfrytëzueset e cekura në pikën 1 dhe 2 të nenit 1, të këtij vendimi, që pronën e paluajtshme të cekur në pikën 1 dhe 2 të nenit 1, të këtij vendimi, ta shfrytëzojnë me mirëbesim si nikoqire e mirë, që mos t’ia humbë vlerën e saj.

4.2 Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Suharekës dhe si e tillë ajo nuk mund t’i epet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr-10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËSNË SUHAREKË

01-Nr-~~016~~-7814
Më datë 30.01.2020

